Fondi i Gjelbër për Rritje Aksionet-A

Lokacioni:
Rajonal

Projekti numër:
51440

Sektori i biznesit:
Kredi jo-depozitare (jo bankare)

Lloji i njoftimi:
Privat

Kategoria mjedisore:
FI

Data e synuar e Bordit:
11 dhjetor 2019

Statusi:
Ka kaluar shqyrtimin përfundimtar, në pritje të aprovimit të Bordit

Data e shpalosjes së DPP në anglisht:
23 tetor 2019

Përshkrimi i projektit

Transaksioni i propozuar është një ri-investim deri në 20 milion euro në aksione senior të klasës A të FGjRr-së.

Objektivat e Projektit

Të ardhurat nga investimi i BERZH-it do të përdoren për huazim për institucionet partnere financiare dhe jo-financiare (IP) në përputhje me udhëzimet e investimit të Fondit. Kreditë për IP-të janë në formën e borxhit senior, borxhit të varur dhe garancive, dhe synojnë të financojnë Efikasitetin e Energjisë (EE), Efikasitetin e Burimeve (EB) dhe projektet e energjisë së ripërtërishme në të gjithë rajonin e synuar të Fondit, përfshirë Evropën Juglindore, Rajonin Lindor dhe Jugor të Fqinjësisë së Evropës (RFE).

Ndikimi i Tranzicionit

Duke siguruar fonde shtesë për FGjRr-në, transaksioni do të kontribuojë më tej në shkallëzimin e financave të gjelbra në rajonin e synuar të FGjRr-së, si përmes bankave tregtare lokale, ashtu edhe përmes investimeve të drejtpërdrejta në projekte të energjisë së ripërtërishme, duke mbështetur zhvillimin e sektorit privat dhe arritjen e ndikimeve pozitive mjedisore. Për më tepër, Fondi do të vazhdojë të tërheqë pjesëmarrjen e sektorit privat në strukturën e vet të kapitalit, duke siguruar një pjesë të qëndrueshme dhe në rritje të fondeve të sektorit privat për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe aktivitetet e adaptimit.

Informacioni i Klientit

FONDI I GJELBËR PËR RRITJE, EVROPA JUGLINDORE SA SICAV-SIF

Fondi i Gjelbër për Rritje është një kompani investimesh e organizuar sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut. Fondi është themeluar në dhjetor 2009 nga BEI dhe KfW me qëllim zgjerimin e bazës së financimit të Efikasitetit të Energjisë dhe Investimeve të Energjisë së Ripërtërishme në Evropën Juglindore, përfshirë Turqinë, si dhe në rajonin e afërt Lindor të Fqinjësisë Evropiane dhe në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Aktivitetet e FGjRr-së mbështeten edhe nga një Instrument i Asistencës Teknike që ofron mbështetje të mëtejshme teknike për IF-të dhe huamarrësit fundorë për investime të gjelbra.

Përmbledhja e Financimit të BERZH-it

20,000,000.00 EURO

Gjithsej Kosto të Projektit

20,000,000.00 EURO

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

I kategorizuar FI (ESP 2014): Përmes investimit të propozuar, FGjRr-ja do të kërkohet të vazhdojë të jetë në pajtim me KP-të 2, 4 dhe 9; të zbatojë dhe të jetë në pajtim me procedurat përkatëse mjedisore dhe sociale (MS) të BERZH-it; dhe të dorëzojë raporte vjetore mjedisore dhe sociale në BERZH.

Bashkëpunimi Teknik

Asnjë.

Informatat e Kontaktit të Kompanisë

Lloyd Stevens
L.stevens@finance-in-motion.com
+49 (0)69 271 035 113
https://www.ggf.lu
Carl-von-Noorden-Platz 5, 60596 Frankfurt/Main, Germany

Mundësitë për biznes

Për mundësitë për biznes ose prokurimet, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për projektet e sektorit shtetëror, vizitoni Prokurimet e BERZH-it: Tel: +44 20 7338 6794
Email: procurement@ebrd.com

Informacione të përgjithshme

Informacione rreth projekteve të BERZH-it që nuk lidhen me prokurimet
Tel: +44 20 7338 7168
Email: projectenquiries@ebrd.com

Politika e Informimit Publik (PIP)

PIP-ja përcakton mënyrën se si BERZH-i e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe perceptimin më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të saj Ju lutemi të vizitoni faqen e Politikës së Informimit Publik më poshtë për të mësuar si të kërkoni një Raport të Bordit të Sektorit Publik.
Teksti i PIP-së

Mekanizmi i Ankimimit të Projektit (MAP)

Ky Mekanizëm i Ankimimit të Projektit (MAP) është mekanizmi i llogaridhënies i BERZH-it. Ai siguron mundësinë për shqyrtimin e pavarur të ankesave të individëve dhe organizatave lidhur me projektet e financuara nga BERZH-i, të cilat hamendësohet të kenë shkaktuar, apo kanë gjasa të shkaktojnë dëme mjedisore dhe/ose sociale.

Ju lutemi të vizitoni faqen e Mekanizmin e Ankimimit të Projektit ku do të gjeni informata mbi mënyrën si të parashtroni një ankesë. Zyrtari i MAP-it (pcm@ebrd.com) është i disponueshëm që t'iu përgjigjet pyetjeve që mund të keni në lidhje me parashtrimin e një ankese dhe kriteret për regjistrimin dhe pranueshmërinë, në përputhje me Rregullat e Punës së MAP-it.